REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 114/17
Data/Datum 14.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË

PSH. Nr. 114/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej: z. Tefik Sylejmani - Kryetar,z.Nuhi Paqarizi -referues dhe Goran Milenkoviq -anëtar,duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Botek" – nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me tonera për printera Lot-1", me nr. të prokurimit:214/16/147/111 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Policia e Kosovës , më dt: 26.05.2017, mori këtë :

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e pjesërisht e bazuar ankesa e OE ankues"Botek" – nga Prishtina , lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me tonera për printera Lot-1", me nr. të prokurimit:214/16/147/111 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Policia e Kosovës.

II. **Vërtetohet,** vendimi i autoritetit kontraktues – Policia e Kosovës lidhur me njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me tonera për printera Lot-1", me nr. të prokurimit:214/16/147/111.

III.Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh të njoftoj Panelin Shqyrtues për të të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-ës të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues,që nuk respekton vendimin e panelit shqyrtues të parapar me këtë ligj

V. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Botek" - Prishtinë janë pjesërisht të qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së,i kthehet sigurimi i ankesës OE ankues, në afat prej 60 ditësh janë të obliguar të parashtrojnë kërkesë për tërheqjen e mjeteve në të kundërtën këto mjete barten në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Autoriteti kontraktues Policia e Kosovës ka bërë njoftimin në KRPP me 26.07.2016, procedurë e hapur, vlera e kontratë e madhe për furnizim, afati për ofertim 24.08.2016 ku të njëjtën datë është bërë hapja ofertave.

Kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, kontratë kornizë 12 muaj.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar gjithsej 7 (shtatë)OE.

AK ka formuar komisionin e vlerësimit të ofertave, sipas komisionit Ri-vlerësues, OE të përgjegjshëm janë gjithsej 6 OE, dhe për Lot.1 është rekomanduar për kontratë OE:"Botek".

Pas vendimit të OSHP-së, lënda është kthyer në rivlerësim në pajtim me nenin 72 të LPP-ës dhe pas rivlerësimit për kontratë ka rekomanduar OE:"Infosoft".

Me datë 18.04.2017 OE:"Botek" parashtron ankesë në OSHP, me pretendime ankimore se AK ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 35, 59 të LPP-së.

Aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Pas pranimit të ankesës OSHP, autorizon ekspertin shqyrtues z.Basha për trajtimin e pretendimeve ankimore i cili me datë 10.05.2017 i dorëzon panelit shqyrtues nje kronologji permes se ciles e ka njoftuar panelin shqyrtues me shkresat e lendes, konkretisht komunikimet zyrtare te AK-se, pas vendimit me numer 446/16, ne lidhje me verifikimet e bera nga ana e AK-se. Ne lidhje me verifikimet e bera eksperti shqyrtues, e ka njoftuar panelin shqyrtues se ne pergjigjen e dates 27.03.2017 nga Mark Appleton – drejtor i shitjes për Europ ka deklaruar se Also Internationl nuk eshte i autorizuar te beje biznes ne Kosove. Gjithashtu i njëjti person ka deklaruar ne përgjigje se autorizimet jane te vlefshme vetem per shtet anetare te BE-se.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit te shkresave te lendes, vendosi qe konform nenit 26 te Rregullores se Punës se OSHP-se, te mbaj seance pa prezencën e palëve.

Paneli shqyrtues në seancën e mbajtur me dt. 26.05.2017 në pajtim me nenin 26 të Rregullores së punës së OSHP ku të pranishëm ishin anetaret e panelit shqyrtues dhe eksperti shqyrtues, paneli shqyrtoi shkresat e lëndës si:dosjen e tenderit,ankesën me pretendime ankimore te OE ankues dhe nder te tjera kërkoj nga eksperti shqyrtues qe te ekzaminohet oferta – autorizimi i OE te rekomanduar për kontratë dhe përgjigjja e prodhuesit HP lidhur me autorizimin e lëshuar nga "Also International"për OE ankues"Botek" .

Eksperti shqyrtues gjate seancës deklaroj se autorizimi i OE te rekomanduar për kontratë është i lëshuar nga ITD Sh.p.k. dhe i cili është i autorizuar për Shqipëri dhe Kosovë.

Paneli shqyrtues nga shkresat e lëndës në seancën gjeti se AK-ja, me rastin e ri-vlerësimit të ofertave ka vepruar në pajtim me vendimin e PSH-se, ku ka kërkuar sqarime lidhur me autorizimin e lëshuar per OE ankues "Botek". Ne përgjigjen e datës: 27.03.2017, Mark Appleton – Drejtor i shitjes për Evropë, ka deklaruar se "Also International" nuk është i autorizuar te bëj biznes ne Kosove. Gjithashtu ne një komunikim tjetër përmes email-it, i njëjti person ka deklaruar se autorizimet tona janë valide vetëm për shtet e BE-se.

Paneli shqyrtues nga kjo përgjigje e HP dërguar AK se "Also Internacional"nuk ka të drejtë të bëjë biznes në Kosovë vërteton se autorizimi i OE "Botek" nuk përmbush kërkesat e DT lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues, ka analizuar edhe autorizimin e OE te rekomanduar për kontratë cili ka autorizimin nga "ITD"Shpk dhe njëherit ka bërë verifikim te autorizimit te dorëzuar ne ofertë e tij ku nga linku i HP vërehet se ITD Sh.p.k, është i autorizuar për territorin e Shqipërisë dhe Kosovës.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe atë: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues Gjeti se AK ka vepruar në pajtim me vendimin e paneli shqyrtues dhe dispozitave të LPP-ës.

Andaj duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Tefik Sylejmani

REPUBLIKA E KOSOVËS
PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT
PRISHTINË
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIKA RAZMATRANJE NABAVKI
REPUBLIKA KOSOVA